



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Propozuar/Delivered	29.03.2022	2 viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Dr. Prot Dr. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRPMEHCK	1662/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.127/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci – Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.127/2022 të datës 14.02.2022 të parashtruar nga ankuesi , me adresë:

Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, kundër organit të punësimit Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 29.03.2022 mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.127/2022 e datës 14.02.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, sipas Akt emërimit të datës 01.01.2015 në pozitën “Teknik i Meteorologjisë në IHMK-së”, me dtë 13.12.2013, Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, nxjerr Vendim me numer Nr.619/AMMK/2013, me te cilin ankuesin e cakton në pozitën "Koordinator i IHMK-AMMK për pranimin, përpunimin, raportimin e të dhënave metrologjike si dhe përgatitjen e parashikimit të motit”.

Ankuesi me datë 11.06.2021 parashtron kërkesë me numër protokollit 2281/21 tek Zëvendësuesi i Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, i cili kërkon që ti ndryshohet Akt emërimi i datës 01.01.2015, në bazë të pozitës dhe koeficientit të pagës së përcaktuar sipas Vendimit me numer Nr.619/AMMK/2013 të datës 13.12.2013, si dhe ti bëhet kompensimi e diferencës së të ardhurave (pagës) që rrjedh nga pozita e "Koordinatorit të IHMK-AMMK”, që nga data e nxjerrjes së vendimit e deri me sot .

Zëvendësuesi i Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës me datë 24.06.2021 i përgjigjet permes e-mail ku e njofton ankuesin se kërkesa e tij është percjelle ne Zyren Ligjore dhe Divizionin per Burime Njerezore mirepo deri me kete date date nuk kane marre pergjigjje. Divizionin per Burime Njerezore me date 10. 08.2021 i pergjigjet ankuesit duke e njoftuar se ndryshimi i aktemerimit dhe koeficientit behet vetem me procedure rekrutuese avancim dhe se per cdo koeficient duhet te kete mbulesa buxhetore



I pa kënaqur me përgjigjen e datë 24.06.2021, ankuesi ka parashtruar ankesë me datë 14.02.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokoll 1715/2022 , me pretendime ankimore që ti ndryshohet Akt emërimi i datës 01.01.2015, në bazë të pozitës që ushtron sipas Vendimit me Nr.619/AMMK/2013 të datës 13.12.2013, duke kërkuar koeficientin e pagës së përcaktuar sipas detyrave të punës nga pozita "Koordinatori i IHMK-AMMK", dhe diferencën e pagës që rrjedh nga kjo pozitë deri me tani.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 21.02.2022 e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankese për ankuesen tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, ndersa me datë 25.02.2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankese nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, me shkresat e bashkëngjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 1715/2022 e datës 14.02.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër rendor A.nr.127/2022; Vendimin e datës 13.12.2013 me Nr.619/AMMK/2013; Akt emërimi i datës 01.01.2015; Përgjigje e datës 25.02.2022; Përgjigje ne ankese e datës 24.06.2021, lidhur me ankesen Anr.527/2021 të datës 11.06.2021 për ankuesin të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë e dates 11.06.2021 nr. Protokoll 2281/21; Letër përcjellese e dates 24.06.2021; Detyrat e pozitës:Teknik i meteorologjisë; Vendim Anr.800/2018 i datë 15.01.2019 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. Protokoll 222/2019; E-mail i datës 10.08.2021 dhe i datës 29.06.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjithave shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa lejuar, sepse**

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesja me datë 11.06.2021 ka parashtruar ankesë numër protokoll 3016/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër të regjistruar A.nr.527/2021, për të njëjtin objekt ankimor, gjegjësisht pretendimet e njëjta duke pretenduar që ti bëhet ndryshimi i Akt emërimit të datës 01.01.2015, në bazë të pozitës së caktuar me Vendimin me Nr.619/AMMK/2013 të datës 13.12.2013, për pozitë: "Koordinatori i IHMK-AMMK", në Drejtorinë e IHMK-së. duke kërkuar koeficientin e pagës së përcaktuar sipas detyrave të punës nga kjo pozitë si dhe diferencën e pagës që nga data e nxjerrjes se vendimit e deri me sot, për të cilën ankese ankuesi ka pranuar Njoftimin e datës 23.07.2021 me nr. protokoll 3861/2021, lidhur me mos funksionimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të cilin njoftim e ka pranuar me datë 09.08.2021 sipas fletëkthesës, ***citoj: "...Andaj, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ju informojmë që në bazë të legjislacionit pozitiv keni të drejt ti ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative".***

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave , ka konstatuar se ankuesi kundër njoftimit të datës 23.07.2021 me nr. protokoll 3861/2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ka qenë i obliguar për të iniciuar procedurën administrative në konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ, e jo siç ka vepruar në rastin konkret duke ripërsëritur të njëjtën ankese me datë 14.02.2022, me numër protokoll 715/2021 e regjistruar me A.nr.127/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar që ti bëhet ndryshimi i Akt emërimit të datës 01.01.2015, sipas Vendimit me Nr.619/AMMK/2013, të datës 13.12.2013 për pozitën "Koordinatori i IHMK-AMMK", në Drejtorinë e IHMK-së.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave , ka konstatuar se në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, të nenit 24 paragrafi 3 të këtij Ligji, çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, duke u lidhur me dispozitë ligjore të nenit 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet afati i ankesës, citoj” **1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ**”, që në rastin konkret ankuesi me rastin e ri përsëritjes së ankesës nga data 11.06.2021 edhe me datë 14.02.2022 për të njëjtës çështje në Këshill, ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e lartë cekur.

Andaj, duke u bazuar të dispozitat ligjore si më lartë dhe duke marrë parasysh se ankuesi lidhur me ankesën e parë të datës 11.06.2021 është njoftua me datë 23.07.2021 për mos funksionimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji konstaton se ankuesi me datë 14.02.2021 ka parashtruar ankesën e dytë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të njëjtën çështje, e cila është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kundërshtim me Njoftimin e datës 23.07.2021, ku është udhëzuar për procedurat e mëtejme në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Konfliktin Administrativ.

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me A.nr.127/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës ;
- Udhëheqëses së Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.